

**ILIR KALEMAJ**

**NDRYSHIMET TERRITORIALE DHE INXHINIERIA E  
KUFIJVE NË RASTIN SHQIPTAR: PËRPLASJA E ELITAVE,  
NDËRHYRJA NDËRKOMBËTARE DHE IMAGJINATA  
KOLEKTIVE (1912-1920)**

*“Ekzistenca e vendeve fqinjë është e vetmja garanci që një komb ka kundër një lufte civile permanente”. Paul Valery*

*“Mekanizmi kryesor në ruajtjen e kufijve është kundërvënia. Me përkufizim, kufijtë janë kundërvënës dhe varen nga pala tjetër.”<sup>1</sup>*

*“...të gjithë kufijtë dhe territoret, edhe ato që duken ‘normal’ apo ‘natyral’ janë konstruksione shoqërore.”<sup>2</sup>*

**Hyrje**

Nxitesit kryesorë të ndryshimeve të hartës simbolike të kombit dhe kufijve virtualë të tij në periudhën mes dy Luftërave Botërore janë *elitat konkurruese*, të cilat nëpërmjet projekteve alternative që përshateshin me kalkulimet e tyre politike, por që njëkohësisht kishin përplasje mes njëri-tjetrit, diktuan formën e hartës të imagjinuar ekspansioniste/reduksioniste të kombit shqiptar. Ndërsa përplasja e elitave ishte një prej shkaqeve themelare në territorializimin identitar dhe krijimin e hartës kombëtare të shqiptarëve, ndërhyrja e drejtpërdrejtë dhe e tërthortë ndërkombëtare dhe rrethanat gjeopolitike përbënin anën tjetër të monedhës që kushtëzonte veprimin politik të elitave të brendshme. Në varësi të ndërveprimit mes përplases së projekteve konkurruese të elitave dhe shkallës së ndërhyrjes së jashtme, si dhe llojin e saj<sup>3</sup> kemi edhe variante të ndryshme të

<sup>1</sup> Daniele Conversi, “Reassessing Theories of Nationalism: Nationalism as Boundary Maintenance and Creation”, *Nationalism and Ethnic Conflict*, vol.1, no. 1, Spring, 1995, f. 73-85.

<sup>2</sup> Alexander C. Diener, and Joshua Hagen ed. 2010, *Borderlines and Borderlands: Political Odities at the Edge of the Nation-State*, London: Rowman & Littlefield Publishers, Inc., f. 4.

<sup>3</sup> Këtu vlen të veçojmë prirjen për maksimizim të hartës etnike shqiptare të Austro-Hungarisë në formësimin e shtet-kombit shqiptar përkundrejt Shqipërisë së ‘vogël’ dhe të copëtuar që kërkonin pandërprerë Rusia, vendet e Aleancës Ballkanike, por edhe Franca dhe Anglia.

projektimit të hartës nacionale *konkrete* dhe asaj të *imagjinuar* (të rrudhosur/kontraktuar, ekspansioniste, neutrale apo ambivalente respektivisht).

Kërkesat e para politike për sovranitet të plotë filluan rreth fundit të 1911-ës dhe fillimit të 1912-ës dhe shpjegimi më i mirë shkak-pasojë bazohet në një analizë empirike që çon te argumenti se elitat konkurruese ishin aktorët e brendshëm kryesorë që në betejën e tyre për të siguruar pushtet dhe hegjemoni të brendshme konfiguruan dhe hartën politike të kombit dhe përfytyrimin imagjinar të tij. Një rol qendror natyrisht luajtën dhe elitat shqiptare në vendet fqinjë si dhe roli i patjetërsueshëm i diasporës. Pas Shpalljes së Pavarësisë, përpjekjet e ‘etërve themelues’ u kurorëzuan me sukses, pasi pushteti u fitua dhe vazhdoi të ruhej në një kontekst krejt tjetër, ku komb-fomimi u shoqërua me krijimin e një përfytyrimi mbi kombin nga masat e gjera popullore, të cilat duhet të edukoheshin me këtë sentiment të ri por dhe me përfytyrimin vizual të hapësirës gjeografike që do të përbënte shtratin ‘natyral’ të shtet-kombit të ri. Mandej, në vitet 1912-1915, elitat e reja patriotike ishin në garë me elitat proosmane dhe një pjesë të elitës së financuar nga Beogradi, të cilat nxitnin projekte lokaliste dhe rivale me atë të qeverisjes qendrore. Kjo përplasje elitash u reflektua në projektimin e ndryshëm të hartës simbolike të komb-shtetit të ri dhe kufijve virtualë, natyrisht në përputhje me diktimin që bënin rrethanat e reja gjeopolitike dhe ndërhyrjen e drejtpërdrejtë apo indirekte të Fuqive të Mëdha si dhe të vendeve fqinjë me projektet e tyre paralele.

### **Përplasjet e elitave dhe forma e hartës kombëtare nga Pavarësia e Shqipërisë deri në Luftën e Parë Botërore**

Evidenca historike na tregon që shqiptarët, deri në momentet e fundit të shembjes së Perandorisë Osmane, e konsideronin këtë të fundit si të keqen më të vogël, krahasimisht me orekset territoriale që ushqenin Serbia dhe Greqia. Ndërsa pas Shpalljes së Pavarësisë, shteti i ri shqiptar ishte mjaft i dobët t’ju kundërvihej Aleancave Ballkanike për të maksimizuar hartën e pretenduar dhe të bënte pjesë të njësisë së tij, territore të konsideruara si pjesë historike të kombit.<sup>4</sup> Por harta e

<sup>4</sup> *Historia e Popullit Shqiptar, Periudha e Pavarësisë 28 Nëntor 1912 - 7 Prill 1939*, vëll. III, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007.

Shqipërisë Etnike, së paku e artikuluar politikisht (fillimisht si njësi autonome nën autoritetin e Sulltanit ku do bashkoheshin katër vilajetet me shumicë shqiptare) dhe e imagjinuar masivisht datonte së paku qysh nga Lidhja e Prizrenit.<sup>5</sup> Shqipëria Etnike, ndonëse u shpall në Vlorë më 28 nëntor 1912, nuk mundi *de jure* dhe *de facto* të arrinte njohjen konstitutive dhe deklarative të Fuqive të Mëdha. Megjithatë, Kuvendi i Vlorës, që bëri të mundur Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimin e qeverisë së përkohshme më 4 dhjetor 1912, mes 63 delegatëve të saj,<sup>6</sup> kishte 16 nga Kosova, Shkupi<sup>7</sup> dhe qytete të tjerë, ndërsa 7 prej tyre ishin nga Çamëria.<sup>8</sup> Duket se përqindja e shqiptarëve etnikë që erdhën si delegatë në Vlorë përkonte më së miri me përqindjen e popullsisë shqiptare në këto troje që ngelën jashtë kufijve të shtetit të sapoformuar shqiptar. Për më tepër, shqiptarët e trojeve u përfaqësuan në qeverinë e re. Për shembull, ministër i Luftës ka qenë Mehmet Pashë Derralla, që ishte nga Tetova e Maqedonisë së sotme, në atë kohë pjesë e vilajetit të Manastirit, ndërsa kryetari i Pleqësisë, që kishte për detyrë të kontrollonte dhe këshillonte qeverinë, ishte Vehbi Dibra-Agolli nga Dibra.

Kjo tregon dy gjëra: së pari, persistencën e një harte të zgjeruar të një kombi me kufij virtualë që nuk korrespondonin me realitetin gjeopolitik të ditës. Së dyti, elitat e brendshme ishin në përpjekje të vazhdueshme për të

---

<sup>5</sup> Studime të fundit e shohin lindjen dhe gjenezën e nacionalizmit shqiptar mjaft më herët, duke filluar me Pashallëqet e Mëdha. Shih Dritan Egro, “Disa të dhëna të reja mbi fillimet e nacionalizmit shqiptar”, *Studime Historike*, 3-4/2010, Tiranë: 2011.

<sup>6</sup> Ndonëse delegatët në të gjitha ditët mund të arrinin në rreth 83, nuk kemi një numër qartësisht të konfirmuar dhe dokumentuar. Shih *Historia e Popullit Shqiptar ...*, III.

<sup>7</sup> Shkupi është bërë zyrtarisht kryeqyteti i Republikës së Maqedonisë vetëm pas Luftës së Dytë Botërore. Nga 1879 deri më 1893, kryeqyteti i vilajetit të Kosovës ka qenë Prishtina, ndërsa nga 1893 deri më 1912 ka qenë Shkupi. Shih Halil İnalcık, “Capital Formation in the Ottoman Empire” (1969), *The Journal of Economic History*, Vol. 29, No. 1, The Tasks of Economic History, 1969, f. 97–140. Kjo tregon një lloj harte etnike imagjinare të elitës shqiptare të kohës.

<sup>8</sup> Për një trajtim të spastrimit etnik të çamëve, veçanërisht përgjatë dy Luftërave Botërore dhe pas Luftës së Dytë Botërore dhe deportimin e tyre masiv në Turqi dhe Shqipëri shih *inter alia*: Miranda Vickers, “The Cham Issue - Where to Now?” Defense Academy of the United Kingdom: Conflict Studies Research Center, 2007.

tërhequr në bashkë-qeverisje dhe ndarë pushtetin me elitat e ‘jashtme’.<sup>9</sup> Një justifikim për këtë mund të ketë qenë dëshira për t’u dhënë sinjale të qarta bashkatdhetarëve, kudo që ata shtrihen në territoret përreth se ata do të vazhdonin të ishin të përfaqësuar në shtet-kombin e ri dhe çdo lloj koniunkte gjeopolitike jo e favorshme, do të kishte vetëm efekt të përkohshëm. Pra, bashkimi i shtetit me kombin në një entitet homogjen, me kufijtë ‘virtualë’ që ndërthuren me ata ‘materialë’ duket se ishte më tepër një zgjedhje e ndërgjegjshme e elitave ‘të brendshme’ dhe ‘të jashtme’, që arritën një pakt politik për të ruajtur dhe ndarë pushtetin dhe kultivuar idenë se ndarja e trojeve shqiptare ishte një sakrificë e përkohshme që do kapërcehej në të ardhmen sesa të qënurit *ex ante* të bashkuar në konceptimin unitar të përfytyrimit të kombit. Me fjalë të tjera dhe duke perifrazuar D`Anzegli-n kur fliste për Italinë, pasi u krijua Shqipëria filloi të krijohet kombi shqiptar, në kuptimin e tij imagjinar dhe politik. Ndërkohë, pas Konferencës së Ambasadorëve në Londër, kur fati dhe forma e komb-shtetit të ri u vulos, qasje të ndryshme të konfigurimit territorial të kombit shqiptar filluan të diskutoheshin në mënyrë pasionante.<sup>10</sup>

Me fjalë të tjera, pas Shpalljes së Pavarësisë, ndërsa po ndodhte shtet-formimi në Shqipëri, harta virtuale gradualisht u tkurr, për shkak të përplasjeve të elitës mbi vizionet e kombit dhe kufijve të saj, me shumë liderë lokalë kundërshtarë të projekteve në shkallë kombëtare. Në vend të kësaj ata po favorizonin mjaft autonominë lokale, për shkak se shteti

<sup>9</sup> Këtu nuk përfshihen vetëm elitat në trevat shqiptare që mbetën eventualisht jashtë kufijve zyrtarë të Shqipërisë por edhe elitat diasporike të cilat ndonëse e ushtronin veprimtarinë e tyre formale jashtë vendit, efektet synonin vetëm kohezionin gjithëpërfshirës të një Shqipërie etnike, të njohur ndërkombëtarisht me kufijtë e vetë natyralë.

<sup>10</sup> Një temë e vazhdueshme nacionaliste në Shqipëri ka qenë që ndërsa Republika e Shqipërisë ka vetëm 28.750 km<sup>2</sup>, gjeografia reale e kombit përfshin Kosovën me 10.887 km<sup>2</sup>, Çamërinë me 15.674 km<sup>2</sup>, Iliridën (Maqedoninë) me 15.074 km<sup>2</sup>, Malësinë me 6.482 km<sup>2</sup>, Sanxhakun me 4.504 km<sup>2</sup>, dhe Toplicë (Lugina Preshevës) 6.645 km<sup>2</sup>. Sipas pikëpamjeve më ekspansioniste, gjithë ‘Shqipëria natyrale’ shtrihet në 87.981 km<sup>2</sup>. Intervistë me Koço Danaj, nëntor 2011. Ndërsa po t’i referohemi historiografisë zyrtare, “trungu etnik zinte një sipërfaqe prej gati 52 mijë km<sup>2</sup>, me rreth 1.550.000 banorë, nga të cilët 1.330.000 shqiptarë”, nga të cilat siç dihet vetëm 28.000 km<sup>2</sup> me një popullsi prej vetë, 740.000 banorësh iu akordua shtetit të sapoformuar shqiptar nga Konferenca e Londrës. *Historia e Popullit Shqiptar...*, III, f. 4

shqiptar i sapokrijuar nuk kishte kapacitet apo nxitje për t'u zgjeruar. Bernd Fisher me të drejtë e përshkruan këtë si një periudhë ku "krenaria lokale ishte e vetmja formë ekzistente e nacionalizmit, në shumicën e vendit".<sup>11</sup> Kështu ne shohim një tkurrje të hartave konkurrenente, kryesisht për shkak të kufizimeve ndërkombëtare, me disa liderë lokalë që luftojnë për të krijuar principatat e tyre të vogla, ku ata mund të qeverisin nën mbrojtjen e njërit prej vendeve fqinjë ballkanas.

Nga viti 1912 më 1914 shohim një përplasje të fortë mes udhëheqësve lokalë të cilët kontrolloheshin pjesërisht dhe shpeshherë edhe instrumentalizoheshin nëpërmjet kontrollit direkt të Fuqive të Mëdha apo vendeve fqinjë. Ishte kjo periudha në të cilën Fuqitë e Mëdha, të cilat kishin krijuar Komisionet Ndërkombëtare për kufirin verior dhe atë jugor dhe që arritën nëpërmjet **inxhinierisë kufitare** të përpunonin harta që përshtateshin me qëllimet e tyre. Nga 1914 më 1917, për shkak të një kombinimi të kufizimeve të reduktuara të jashtme, si pasojë e transfertave të pushtetit drejt Princit të kurorëzuar shqiptar të sapoemëruar, Vid-it dhe përplasjeve të vazhdueshme të elitës, kemi një tkurrje harte përkundrajt projekteve të zgjerimit. Në këtë periudhë, është dëshmuar një zhvendosje drejt tkurrjes etnike ndërsa rryma e fortë irredentiste e viteve 1912-1913 e përfaqësuar nga Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri dhe e përkrahur nga Ismail Qemali dhe qeveria e përkohshme e Vlorës, tashmë ishte zëvendësuar me projekte anakronikë, krijim principatash dhe feudesh lokalë që, së bashku me kryengritjen regresive të Shqipërisë së Mesme nga maji i 1914-ës deri në qershor të 1915-ës, maksimizonin shtrirjen e Serbisë dhe Malit të Zi në Veri dhe Greqisë në Jug në dëm të hartës kombëtare dhe shtetërore të Shqipërisë.

Më pas kemi një periudhë të mbizotërimit të elitave vendase, të kushtëzuar fort nga ndërhyrjet e jashtme (për shkak të Luftës së Parë Botërore). Për shkak se kjo paqartësi zgjati për të paktën tre vjet (1914-1917), secili projekt **hartëzimi** i përkrahur nga dy kampet rivale nuk mundi të sigurojë një fitore bindëse, duke projektuar kështu një hartë neutrale si rezultat i përleshjeve të këtyre elitave. Me fjalë të tjera, harta megjithëse ndryshoi disa herë, asnjë version i saj nuk fitoi shumë popullaritet në secilën anë të kufirit.

---

<sup>11</sup> Bernd Fisher, *King Zog and the Struggle for Stability in Albania*, Eastern European Monographs, 1984, f. 306.

Pra, pas periudhës që shënjoji Shpalljen e Pavarësisë, përplasja e elitave filloi brendapërbrenda shtetit të porsakrijuar, ndërkohë që elita e shqiptarëve jashtë kufijve zyrtarë ka qenë përgjithësisht më e unifikuar në qëndrimin e saj ekspansionist që kërkonte ribashkimin e trojeve shqiptare në një shtet të përbashkët. Brenda vendit, qeveria e Plakut të Vlorës u sabotua nga aktiviteti i Esat Pashë Toptanit me qeverinë e vet paralele, të shpallur në tetor 1913<sup>12</sup> dhe krahina gjysëmautonome e Mirditës, e cila kishte një traditë vetëqeverisje.<sup>13</sup> Në këto kushte, Shqipëria ‘legjitime’ nuk kishte zgjidhje, veçse të reduktohej në kufijtë e lejuar ndërkombëtarisht, me njohjen formale që do vinte rreth një dekadë më pas. Nga ana tjetër, pushtete lokalë si ai i Esat Pashës në Shqipërinë e Mesme, lokaliteti i Mirditës etj., konkurronin me qeverisjen legjitime të Vlorës, duke e bërë akoma më të zvogëluar hartën imagjinare të kombit dhe reduktuar ndjeshëm fuqinë e aparatit shtetëror dhe institucioneve qendrore. Sikundër shkruan Romeo Gurakuqi për Esat Pashë Toptanin, “ai ka qenë përfaqësuesi tipik i një Shqipërie ndryshe, që mbartej në mendjet e kastës së bejlerëve pro-otomanë dhe të pasuesve të tyre injorantë: një Shqipëri e vogël e qethur nga kristianizmat antike iliriko-arbnore dhe epirotë-arbnore, e drejtuar nga një princ otoman, me lidhje të fuqishme me perandorinë aziatike dhe puthadorase me fuqitë ballkanike, të cilave, në këmbim, do t’u jepte çdo gjë nga Shqipëria e krishterë; një Shqipëri para së gjithash antiaustriake dhe për rrjedhojë jo më kurrë adriatikase”.<sup>14</sup> Krahina të tëra në veri të vendit nga Malësia e Madhe deri në Lezhën e komanduar nga Ded Coku ‘Shqipëritë e Vogla’ konkurronin me pushtetin e qeverisë së Vlorës ndërkohë që Jugu që i pushtuar nga trupat greke.<sup>15</sup> Ndërkohë, duhet theksuar prirja fillestare progreke e Ismail Qemalit e parë në rrafshin gjeopolitik si një mënyrë për t’iu

<sup>12</sup> Emri zyrtar i qeverisë paralele të Esat Pashës ishte ‘Pleqësia e Shqipërisë së Mesme’. Kjo qeveri kishte fuqi *de facto* në një pjesë të mirë të territorit, veçanërisht në Shqipërinë e Mesme. Nga jashtë ishte e mbështetur kryesisht nga Beogradi veçanërisht në aspektin financiar, apo trajnimet ushtarake etj. Shih *Historia e Popullit Shqiptar...*, III.

<sup>13</sup> Hysni Myzyri, *Historia e Popullit Shqiptar per shkollat e mesme*. Tirane: Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1994.

<sup>14</sup> Romeo Gurakuqi, *Principata e Shqipërisë dhe Mbretëria e Greqisë, 1913-1914: Çështja e Shqipërisë së Jugut ose e “Vorio-Epirit”*, Universiteti Evropian i Tiranës, Instituti i Historisë Bashkëkohore, Tiranë: 2011, f. 47.

<sup>15</sup> *Po aty*, f. 105.

kundërvënë ekspansionit pansllav sikundër kanë theksuar studime të fundit, prirje e cila i kishte fillesat e veta me gazetën “Sotiria-Alvania” botuar nga I. Qemali qysh më 1901<sup>16</sup>, kohë ku nisën dhe kontaktet e para të tij me politikanët grekë.<sup>17</sup> Ndonëse duhet vënë re se në këtë periudhë kjo prirje ka ardhur duke u zbehur gjithnjë e më shumë, veçanërisht duke filluar nga 1908-ta, derisa në prill të 1913-ës, thuajse ishte venitur.<sup>18</sup> Një aleancë e tillë natyrisht kishte kundërshti nga elita proturke, proitaliane apo ajo proaustriake dhe shkaktonte njëfarë tensioni të projektuar nga jashtë brenda duke kufizuar hartën imagjinare të shtet-kombit shqiptar.<sup>19</sup> Shqipëria e atyre viteve, veçanërisht më 1914 ishte thellësisht e ndarë dhe “aspak e njësuar në segmentet përbërës të popullsisë së saj”.<sup>20</sup>

Ndërsa liderët e shqiptarëve të Kosovës, si H. Prishtina, I. Boletini etj., ndryshonin nga ata brendapërbrenda kufijve të Shqipërisë, për shkak se ishin më të unifikuar në qasjen e tyre kombëtariste duke avokatuar pandërprerë nevojën imediate të unifikimit të vendit dhe rivendikimin e territoreve të copëtuara nga ajo që konsiderohej si vendi amë, Republika e Shqipërisë. Kjo natyrisht shkon kundër asaj që ka argumentuar historiografia serbe ku autor si Mikić kanë theksuar se “leadershipi i shqiptarëve në vilajetin e Kosovës ka kundërshtuar çdo lloj përpjekje nga shqiptarët e Jugut të Shqipërisë për t’i bashkangjitur ata interesave të tyre lokaliste. Bajram Curri dhe Riza bej Kryeziu, liderët e Gjakovës, ishin veçanërisht armiqësorë ndaj Jugut”.<sup>21</sup> Pra, duket se kemi interesa të kitha

<sup>16</sup> Ledia Dushku, *Kur historia ndau dy popuj fqinjë: Shqipëria dhe Greqia 1912-1914*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina KH, 2012, f. 63-64.

<sup>17</sup> *Po aty*, f. 65

<sup>18</sup> *Po aty*.

<sup>19</sup> Interesant është edhe theksi që studiuesja L. Dushku i vë mbështetjes fillestare të Greqisë ndaj kryengritjeve shqiptare të vitit 1910-1911 në viset veriore duke u nisur nga pozita balancuese gjeo-politike (për t’u hapur një front të ri luftime osmanëve ndërkohë që ishin të përfshirë në luftën për Kretën) dhe ndihma politike dhe ushtarake fillestare e grekëve për kryengritësit shqiptarë. Por kjo ishte e kushtëzuar me mos-përhapjen në Jug të vendit ku interesat greke prekeshin drejtpërsëdrejti dhe kur kjo ndodhi, Athina zyrtare u tërhoq nga çdo lloj propozimi për federatë greko-shqiptare apo shteti dualist, sado që këto i kishte propozuar vetë më parë. Shih: L. Dushku, *Kur historia ndau dy popuj fqinj...*, f. 83-84.

<sup>20</sup> Romeo Gurakuqi, *Shqipëria: 1911-1914*, Tiranë: UET Press, 2012, f. 667.

<sup>21</sup> Djordje Mikić, *Austro-Ugarska i Mladoturci 1908-1912*, Institut za Istoriju B. Luka: 1983, f. 165.

të elitave duke pozicionuar ato jashtë kufijve zyrtarë përkundër elitës së shtetit shqiptar, gjë e cila nuk verifikohet nga shqyrtimi i pavarur i burimeve dokumentare të kësaj periudhe dhe për rrjedhojë nuk reflektohen në historiografinë tonë. Përkundrazi elita politike e shqiptarëve të Kosovës ka qenë e palëkundur në pozicionimin e saj për bashkim me Shqipërinë, ndërsa e kundërta nuk mund të thuhet për zhvillimet brenda Shqipërisë Londineze me qeverisjen e autoritetit qendror që dëshronte të vendoste autoritetin e saj “në gjendjen e copëtuar fisnore të shoqërisë shqiptare”<sup>22</sup>, apo me konkurrimin e pandërprerë të autoriteteve lokale.

Krijimi i shtet-kombit të ri më 1912, që në njëfarë mënyre u noterizua nga ana e komunitetit ndërkombëtar me anë të Konferencës së Ambasadorëve më 1913, kishte rëndësi juridiko-politike dhe simbolike në ngjarjet e mëvonshme. Në njëfarë mënyre ndërpreu kohezivitetin e të imagjinuarit kolektiv kombëtar çka u reflektua me zhvillimet e mëvonshme, veçanërisht tek ndikimi që pati te shqiptarët jashtë kufijve. Anëtarët më aktivë të elitës së shqiptarëve të Kosovës u bënë më vonë, përgjatë Luftës së Parë Botërore, pjesëtarë të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” të krijuar në Shkodër së bashku me patriotët shqiptarë më të zëshëm për të luftuar për bashkimin e Shqipërisë me Kosovën në një kohë sa më të shpejtë. Ky Komitet, një organizatë klandestine “që e kishte antarësinë në të dyja anët e kufirit, u formua në 1918 për të promovuar një politikë më agresive të Shqipërisë në Kosovë, kërkonte bashkimin e të gjithë shqiptarëve”.<sup>23</sup> Megjithatë duhet theksuar që ky Komitet e pati jetën e shkurtër dhe nuk arriti t’i realizonte objektivat kombëtariste edhe si rezultat i përçarjes së brendshme politike në vitet 20-të dhe kthimit në kundërshtarë të ashpër të regjimit të Zogut nga ana e disa prej liderëve kryesorë të këtij Komiteti.

Kjo periudhë përsa i përket shqiptarëve etnikë të Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene mund të analizohet nga disa perspektiva. Së pari, ne mund të themi që elita e re ‘kosovare’ po bëhej më aktive në perceptimin si një entitet i ndryshëm dhe i veçantë, jo në linjë me konceptualizimin që

<sup>22</sup> Misha Glenny, *Histori e Ballkanit 1804-1999: Nacionalizmi, Luftërat dhe Fuqitë e Mëdha*, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë: Toena, 2007, f. 227.

<sup>23</sup> Robert C. Austin, “Greater Albania: The Albanian State and the Question of Kosovo, 1912-2001”, in John Lampe and Mark Mazower, *Ideologies and National Identities: The Case of Twentieth-Century Southeastern Europe* eds Budapest: CEU Press, 2004, f.241.

kishin masat dhe elitat drejtuese në Shqipëri duke ndikuar në imagjinatën e kësaj pjese të kombit, i cili sipas Renan është një “plebishit i përditshëm”. Kjo filloi veçanërisht të artikulohej pas Luftës së Parë Botërore ku një pjesë e mirë e elitës nacionaliste në Kosovë u përdoq, u vra apo u burgos nga Beogradi apo nga Tirana zyrtare, shpeshherë dhe në bashkëpunim me njëra-tjetrën sikundër ishte lufta ndaj lëvizjes kaçake në Kosovë të udhëhequr nga Azem dhe Shote Galica. Në fazat e mëvonshme, mungesa e një lidheshipi të pozicionuar qartë për bashkimin në Kosovë, së bashku me faktin që shkollat shqipe u mbyllën dhe mësimi në gjuhën amtare u ndalua si dhe politikat masive asimiluese nga ana e Pasić dhe qeverisë së Beogradit bënë të mundur shuarjen e ngadaltë të aspiratës për ta parë të përmbushur hartën imagjinare të kombit me kufijtë e tij virtualë maksimalë, ajo që patriotët shqiptarë në të dyja anët e kufirit e kanë quajtur në mënyrë të vazhdueshme ‘Shqipëria Etnike’.

**Gjeopolitika e Fuqive të Mëdha dhe ndikimi i saj  
në konfigurimin e hartës territoriale dhe përcaktimin e kufijve:  
ndryshime nga Pavarësia deri në fund të Luftës së Parë Botërore**

Në fazat e hershme të proceseve ballkanike të komb dhe shtetformimit, Fuqitë e Mëdha ishin aktorët kryesorë që “përcaktuan kufijtë dhe përshtatën territoret në konferenca diplomatike dhe imponuan dëshirat e tyre mbi të gjitha palët nëpërmjet diplomacisë së luftanijeve (gunboat diplomacy) dhe sanksioneve ekonomike”.<sup>24</sup> Roli i tyre i padiskutuar por shpeshherë konfliktual, la gjurmët e tij në zhvillimin e përgjithshëm të proceseve kombëtare dhe ndërtimin e kufijve me efekte që zgjatën në kohë. Përpara zhvillimeve të tilla, marrëdhënia e shtetit të ri shqiptar me fqinjët e tij menjëherë pas Shpalljes së Pavarësisë është me interes, sepse tregon shumë mbi përplasjet e elitave dhe se si kjo është reflektuar në territorializimin e identitetit duke projektuar variante të reja dhe konkurruese harte kombëtare.

Kjo ndodhte edhe sepse vendet fqinjë ishin ndërkohë të zëna me krijimin e një fronti të gjerë ballkanik kundër një Perandorie në rënie dhe përjashtonin Shqipërinë sepse kjo e fundit ishte projektuar të copëtohej mes tyre menjëherë pas humbjes së pritshme të të “Sëmurit të Bosforit”.

---

<sup>24</sup> Mark Mazower, *The Balkans: A Short History* (Weidenfeld and Nicolson, 2000), reprinted as *The Balkans: From the End of Byzantium to the Present Day* (Phoenix, 2002), f. 95-96.

Pra Shqipëria u shty drejt një neutraliteti të detyruar, duke u vendosur në pozita vulnerabiliteti. Është ironike që përpara se këto ngjarje të zhvilloheshin, Balugdzic që ishte i dërguari special i Pasić në Shqipëri në fillim të 1913-ës “informoi I. Qemalin gojarisht për mbështetjen e fortë të Serbisë dhe kërkoi një provë të shkruar nga ana e kryeministrit shqiptar për qëndrimin e tij për kufijtë e një Shqipërie autonome të ardhshme, mbi çështjen e aksesit të Serbisë në Adriatik dhe mbi natyrën e lidhjeve politike mes Shqipërisë dhe Serbisë”.<sup>25</sup> Pra, ravijëzimi dhe delimitimi i kufijve shkuan përtej ndarjes thjesht fizike. Ai ishte i mveshur me vlerën simbolike që konceptualizonte kufijtë si përcaktues identitarë ashtu sikundër dhe një shenjë dalluese e real-politikës së re në rajon. Në të kaluarën, përgjatë pesë shekujve të sundimit të Perandorisë Osmane, kufijtë thjesht shërbenin si sinore që ndanin njësi administrative (vilajete, pashallëqe apo sanxhaqe) pa marrë parasysh dallimet apo nuancat etnike, nacionale apo fetare. Zgjedhja e shtetit shqiptar për mos të ndërhyrë në Luftë Ballkanike si një mënyrë për të ruajtur të paktën kufijtë ekzistues, rezultoi të ishte fatale sepse me triumfin e Koalicionit Ballkanik, tokat shqiptare shiheshin si një çmim i majmë për fqinjët veriorë dhe jugorë sipas logjikës që ‘plaçka e luftës’ i takon fituesit. Pavarësisht neutralitetit të vetëshpallur, vetëm ndërhyrja e dy prej Fuqive të Mëdha të kohës, Perandorisë Austro-Hungareze dhe Italisë shpëtuan shtetin e ri nga copëtimi total, megjithëse disa kufij tokësorë u sakrifikuan përgjatë procesit. Veçanërisht vlen të përmendet këtu kontributi i patjetërsueshëm i Austro-Hungarisë, e cila pavarësisht ndonjë rezervimi, shkoi aq larg sa të kërkonte delimitimin e kufijve të Shqipërisë bazuar në parimin e kombësisë dhe kjo jo për shkak të ndonjë ideali Willsonian por bazuar në logjikën e thjeshtë të realpolitikës që bazohet në shtrirjen e zonave të influencës dhe në rastin konkret vendosjen e një barriere sa më të gjerë ekspansionit serb dhe malazez.<sup>26</sup>

Pra, Aleanca e trefishtë e serbëve, grekëve dhe malazezëve ishte e suksesshme në ndarjen e disa prej territoreve që i përkisnin trevave shqipfolëse, të cilat ato i mbajtën të pandikuar nga rrjedhojat e Luftës së Parë Botërore dhe më tej. Pas Luftës së Parë Botërore, shtetet e

<sup>25</sup> D. Mikić, *Austro-Ugarska .....*, f. 181.

<sup>26</sup> Shih për një trajtim të gjerë të rolit Austro-hungarez në përcaktimin e kufijve të shtetit shqiptar: Richard Cooper Hall, *Austria-Hungary and the Northern Albanian Frontier 1912-1913*, Ohio State University, 1974.

pozicionuara në aleancën e mundur, humbën territor ndaj shteteve fqinjë, të tjerë fituan, çka u bë e mundur nga Traktati i Versajës dhe një rikonfigurim i marrëdhënieve ndërkombëtare. Për shembull, Bohemia, Moravia, Sllovakia, Ruthenia e Karpateve dhe territoret fqinjë formuan Çekosllovakinë e re. Galicia, pjesa lindore e Cieszyn si dhe pjesët e rajonit të Orava-s and Spisz u transferuan në Poloni. Bolzano-Bozen dhe Trieste iu dhanë Italisë, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia-Slavonia, Dalmacia, Sllovenia dhe Vojvodina u bashkuan me Serbinë për të formuar Mbretërinë Serbo-Kroate-Sllovene.<sup>27</sup> Nga ana tjetër, Hungaria humbi përafërsisht një të tretën e territorit të saj ndaj Sllovakisë dhe Rumanisë me Traktatin e Trianonit, që ishte një prej traktateve të veçantë të nënshkruar nën suazën e Versajës. Rumania fitoi Transilvaninë si çmimin kryesor dhe Bukovinën por humbi Besarabinë, ndërsa Perandoria Osmane, jo vetëm humbi gjithë çka posedonte, por gjithashtu u shpërbë duke bërë të mundur lindjen e shtet-kombit të ri, Turqisë moderne. Duhet thënë se Shqipëria si një shtet kishte qenë zyrtarisht neutral përgjatë Luftës së Parë Botërore, ndonëse shqiptarët në Gadishullin Ballkanik ishin ndarë përgjithësisht mes entuziazmit për fitoren e Antantës dhe atyre që mbështetën Perandorinë Dualiste, si mirënjohje për ndihmën që ju kishte dhënë para Luftës së Parë Botërore. Megjithatë, në një surprizë aspak të këndshme për patriotët dhe nacionalistët shqiptarë, por dhe shoqërinë në përgjithësi, ishte një surprizë e hidhur fakti i mosshpërblimit me komb-shtetin e shumëpritur që do të përfshinte territoret historikisht të pretenduara.

Teza e shtruar këtu është se 'kufijtë virtualë' që ndikojnë në mënyrën se si kombi vizualizohet në dimensionin e vet territorial nga njerëzit, është kryesisht i ndikuar nga përpjekjet e elitës dhe stimujt që ata kanë për të mbajtur pushtetin. Përdorimi i **inxhinierisë së hartave** si një mënyrë për të manipuluar strategjikisht besimet e njerëzve, emocionet dhe për të devijuar vëmendjen e tyre nga çështjet më të ngutshme (për shembull çështjet ekonomike të ditës), mund të jetë një nga mjetet më efektive në një manual politik në shtetet e reja, shtetet e kontestuara apo edhe regjimet e reja, shpesh të përdorura nga politikanët mendjemprehtë.

---

<sup>27</sup> Margaret MacMillan, *Peacemakers: The Paris Peace Conference of 1919 and Its Attempt to End War* (also titled *Paris 1919: Six Months That Changed the World* and *Peacemakers: Six Months That Changed the World*). London: John Murray Publishers, 2001.

Por, pengesa kryesore ndaj elitave që kanë marrë një rrugë shoviniste, për të rritur shanset e tyre për sukses, janë ndërhyrjet e jashtme që vijnë në forma të fshehura ndryshe. Forma të tilla mund të marrin stimuj apo sanksione ekonomike, kërcënime apo ndërhyrje ushtarake, në skenarë gjeopolitike të cilat shkojnë përtej fuqisë së kufizuar të elitave lokale. Në hyrje të punimit, ne pamë disa rezultate të pritura si rezultat i bashkëveprimit të elitave me njëra-tjetrën në praninë/ mungesën e ndërhyrjes së jashtme. Në përputhje me gjetjet e pritshme në periudhën 1912-1914, shohim një shkallë të lartë të kontrollit ndërkombëtar të drejtpërdrejtë ndaj sovranitetit dhe territorit shqiptar, të ushtruar kryesisht nëpërmjet udhëheqësve lokalë. Në këtë periudhë fillestare Fuqitë e Mëdha, të cilat kishin krijuar krahas Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, edhe komisionet *ad hoc* për përcaktimin e kufijve veriorë dhe jugorë të Shqipërisë arritën nëpërmjet procesit të **inxhinierisë kufitare** të përpunonin hartën që i përshtatej qëllimeve të tyre.<sup>28</sup> Nga 1912-1914, për shkak të një kombinimi të kufizimeve të larta të jashtme, si pasojë e transferimeve të pushtetit shqiptar tek Princi i sapokurorëzuar Vilhem Vidi dhe pranisë aktive të përpjekjeve të elitës, ne shohim një hartë me disa liderë lokalë që luftojnë për të krijuar principatat e tyre të vogla, ku ata mund të sundonin nën mbrojtjen e ndonjërit prej shteteve fqinje të Ballkanit.

Në anën tjetër të kufirit, në Kosovë, ndërhyrjet reale për projektim kufitar të elitave të brendshme, kanë ardhur vazhdimisht nga burime të jashtme, si gjeopolitika e Fuqive të Mëdha ose proceset asimiluese dhe zhvendosjet demografike për një arsye ose një tjetër. Megjithatë, shpesh historianët kanë bërë përdorimin selektiv të burimeve të huaja, të cilat justifikojnë pretendimet e brendshme apo japin argumente për versione të tilla të thjeshtëzuara të historisë zyrtare. Për shembull, historianët shqiptarë citojnë dokumentacionin austriak, i cili sjell të dhëna që dëshmojnë se tokat e Kosovës ishin të banuara nga popullsi shqiptare dhe ata ishin të përfshirë në konceptin 'Shqipëri'. Burime të tilla tregojnë ndër të tjera se: "Prishtina është e vendosur në Shqipëri"<sup>29</sup>; Prizreni është

<sup>28</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, *Rilindja Kombëtare*, vitet 30 të shek. XIX-1912, Akademia e Shkencave të Shqipërisë: Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002.

<sup>29</sup> Injac Zamputi and Selami Pulaha, *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, Vol. IV (1675-1699) [Documents for Centuries XVI-XVII

kryeqyteti i Shqipërisë”, konsiderata e tyre [austriake] ishte se "Kosova ishte pjesë e Shqipërisë"<sup>30</sup>. Këta historianë kanë tendencë të injorojnë kontekstin e burimeve të tilla të dyshimta të cilat shpesh i referohen realiteteve gjeopolitike të ditës, sesa një kombi homogjen të vazhdueshëm me kufij të pandryshueshëm. Gjithashtu zgjedhja e Prizrenit si kryeqytet, ishte ndoshta për shkak të faktit se Lidhja e Prizrenit në vetvete nuk përbënte një vendim të guximshëm politik për të bërë thirrje për sovranitet, por vetëm për autonomi më të madhe për udhëheqjen lokale zyrtare nën sundimin e Perandorisë Osmane.

Është e rëndësishme se si Fuqitë e Mëdha imagjinuan kombin shqiptar, sepse "imaginata" e tyre shërbeu për manipulimin e kufijve që i përshtateshin interesave të tyre dhe kjo lejonte hapësirë për analizë në rastet kur pajtueshmëria ose mospërputhja është dëshmuar ballë për ballë elitave kombëtare. Secila prej Fuqive lëvizi me qëllimin për të përfshirë këto territore në sferën e tyre të ndikimit ose të paktën duke përdorur **hartëzimin e territorit** për qëllimet e tyre strategjike. Për shembull, një telegram i ambasadorit austro-hungarez Pallavicini nga Stambolli për Ministrinë e Jashtme në Vjenë, lidhur me qëndrimin e Perandorisë Osmane kundër Shqipërisë në Stamboll më 25 nëntor 1912, në mënyrë të qartë zbulon vullnetin e Fuqive të Mëdha për ta pranuar sovranitetin e shqiptarëve, megjithëse të kufizuar: “Për çështjen shqiptare, Veziri i Madh më tha se Turqia do të këmbëngulë për krijimin e një Shqipërie autonome me një princ prej mbretërve turk...”<sup>31</sup> Pozicioni i Stambollit u ndryshua në vitin 1912, kur pas vitesh me përpjekje të kota për të shtypur kryengritjet shqiptare, u bashkua më në fund në idenë austro-hungareze për krijimin e një shteti autonom shqiptar dhe duke i lejuar shpalljen e sovranitetit.

Nga dokumentet ne shohim se Perandoria Austro-Hungareze mbështeste në mënyrë të vazhdueshme një Shqipëri të pavarur, sovrane dhe punonte në drejtim të këtij qëllimi me proaustriakët si Syrja Vlora apo Dom Nikoll Kaçorri, i cili u bë zëvendës kryeministër i Shqipërisë së sapokrijuar. Zëvendëskonsulli i Vjenës në Durrës, Rudnay, i kapur në

---

for Albanian History, Vol. IV (1675-1699)]. Academy of Science of Albania. Institute of History. Cit. (dok.3, 129), 1990.

<sup>30</sup> *Po aty*, cit. dok. 114, 126, p. 35B; Shih gjithashtu *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, Vëllimi VI, Përgatitja dhe redaktimi M. Verli, L. Dushku, Botimet Albanologjike, Tiranë: Kristalina KH, 2013, f. 315.

<sup>31</sup> *Po aty*, Zamputi dhe Pulaha 1990.


valët e dhënies së mbështetjes për një Këshill Kombëtar shqiptar dhe duke u përballur me frikën se ndoshta organizimi i saj dhe ngritja e flamurit nuk do të jetë e mundur, gjeti mbështetjen e Kaçorrit për të gjetur disa delegatë në qytetin e tij të lindjes Durrës, të cilët mund të nënshkruanin një deklaratë ku bënin me dije se Vjena ishte aty për t'i dhënë krahë aspiratave kombëtare shqiptare<sup>32</sup>. *E gjithë kjo shërben si dëshmi empirike se (ri)ndërtimi i kufijve të elitave është shumë më i suksesshëm kur është në përputhje me kushtet e favorshme gjeopolitike dhe shumë më pak i suksesshëm kur intervenimi i jashtëm ngushton shkallën e lirisë së lojtarëve të brendshëm*. Shih hartat më poshtë për një pamje grafike të Fuqive të Mëdha alternative në hartën e shtetit shqiptar, në rrethana të ndryshme kritike që kam identifikuar në këtë studim. Kjo na tregon se secila prej Fuqive të Mëdha kishte versionin e saj të preferuar të hartës shqiptare që i përshtatej më së miri interesave të veta dhe rezultati ishte shpesh një kompromis i bazuar në fuqinë e secilës prej Fuqive dhe se sa strategjike konsiderohej për interesin e saj 'jetik'.

---

<sup>32</sup> *Ibid.* Shih gjithashtu: C. Hall, *Austria-Hungary and the Northern ...*. Për më tepër duhet theksuar që Konti Berchtold, ministri i jashtëm i Perandorisë ka qenë në njëfarë mënyre paraprirës i artikulimit për pavarësi të Shqipërisë dhe më tej për delimitimin e kufijve veriorë të saj. Në letrën e dërguar Mendsdorff në 20 mars 1913, ai thekson ndër të tjera: “Jam i bindur që delimitimi i kufijve shqiptarë dhe evakuimi i Aleancës Ballkanike nga Shqipëria janë domosdoshmëri urgjente”, duke shtuar se me këtë rast mund të sakrifikohej qyteti i Gjakovës si një mënyrë për të bindur Fuqitë e Mëdha hezitante për garancinë austro-hungareze. *Ibid.*, Appendix II, f. 126. Ndërsa në një letër dërguar Wilhelm von Storck, Berchtold shkruan se “nën asnjë rrethanë Austro-Hungaria nuk mund të pranojë modifikimin e vendimarrjes ndërkombëtare mbi kufijtë e Shqipërisë”. *Ibid.*, f. 130-131.




Hartë 1 (H Vj 018)<sup>1</sup>: Shqipëria, kufijtë alternativë (si propozohen nga disa Fuqi të Mëdha në dy dekadat e para të shek. XX) Burime: Helmreich (1938: 256); Lendvai (1969: 174)




Hartë 2: Hartë austriake e Shqipërisë Veriore që tregon gjithashtu kufirin gjuhësor të shqiptarëve që duhet të përkonte me kufirin kombëtar<sup>33</sup>

<sup>33</sup> Cooper Hall, *Austria-Hungary and the Northern Albanian Frontier 1912-1913*. Ohio State University, 1974. f. 5.



Hartë 3: Hartë austro-hungareze<sup>34</sup>

<sup>34</sup> Po aty, f. 21.



Hartë 4: Hartë austro-hungareze<sup>35</sup>

*Ndërveprimi i vektorëve të konkurrencës së elitave politike me ndërhyrjen ndërkombëtare dhe projektimi i hartës në të dyja anët e kufirit*

<sup>35</sup> Po aty, f. 41.

Edhe pse gjysma e popullsisë shqipfolëse dhe e territoreve të banuara prej tyre i ishin dhënë Serbisë, lëvizja për çlirim kombëtar e nxitur nga udhëheqja e shqiptarëve të Kosovës në një përpjekje për të bashkuar Shqipërinë, nuk pushoi për gati një dekadë. Në fakt, disa prej liderëve të njohur nacionalistë që po e mendonin rezultatin e Konferencës së Londrës si të përkohshëm dhe kishin shprehur se kufijtë do të zhvendosen përsëri në mënyrë që të realizojnë bashkimin e tokave shqiptare, vinin nga diaspora ngjitur. Ata i kishin shndërruar fjalët në veprime, që do të thotë se ata po kombinonin agjitacionin patriotik (kryesisht elita kulturore) me luftën (elita politike dhe ushtarake). Ndryshe nga vendet fqinje të Shqipërisë, e cila u kap në përpjekjet e brendshme të elitës sidomos nga 1914-1917, duke adoptuar versionet reduktuese të hartës dhe duke u kujdesur për politikën e tyre, qëllimi kryesor i udhëheqjes kosovare ka qenë vazhdimisht bashkimi me 'atdheun' gjatë gjithë kësaj periudhe. Parashikimet e ofruara nga konkurrenca dhe përplasja e elitave dhe vizioneve respektive të tyre në të dy anët e kufirit ka qenë e determinuar nga kushtëzimet e jashtme, duke çuar në projektimin e kufijve të caktuar në një kohë të dhënë dhe që në periudhën nga Pavarësia e Shqipërisë më 1912 deri në fillim të Luftës së Parë Botërore ka ndryshuar disa herë sikundër tregon dhe tabela më poshtë.

Tabela 1. *Parashikimet për rezultatet mbi kufijtë prej Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë deri në Luftën e Parë Botërore*

Situata në Shqipëri	Konkurrenca/Përplasja e elitave	Kufizimet ndërkombëtare	Rezultatet në projektimin e kufijve
(1912-1914)	Nivel i lartë i konkurrencës. Udhëheqja kombëtariste fiton rol kryesor në luftën e brendshme, duke çuar drejt maksimizimit të kërkesave irredentiste (unifikim të trungut etnik) dhe krijimit të vizioneve pankombëtare.	Përgjithësisht presione të jashtme mesatare në këtë periudhë. Konferenca e Ambasadorëve ra dakord të njohë pavarësinë, duke përfshirë gjysmën e territoreve që nacionalistët kërkonin të arrinin. Vidi është pranuar nga të gjitha Fuqitë e Mëdha si princ i Shqipërisë në dhjetor 1913. Ndërkohë Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit për Jugun përfundon punën në dhjetor 1913, me nënshkrimin e Protokollit të Firences. Komisioni i Veriut nuk arriti ta përfundonte punën, e cila u ndërpre për shkak të nisjes së Luftës së Parë Botërore.	Zgjerimi kufitar nacionalist si retorikë mbizotëruese nga 1912 deri në fillimet e 1914, koncepti i një "Shqipërie të Madhe" tema dominuese.
(1914-1917)	Përleshjet e elitës mbi vizionet e kombit dhe kufijtë e saj, me shumë liderë lokalë kundërshtarë të projekteve në shkallë kombëtare. Përkundrazi duke favorizuar autonominë vendore. Largimi i Ismail Qemalit, nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, hapi mundësinë për drejtuesit lokalë si Esad Pasha, i cili kishte bërë disa marrëveshje me serbët qysh më 1913 e mandej, të pranorin shumë prej Shqipërisë ekzistuese në këmbim të autonomisë së Shqipërisë së Mesme, qeverinë e së cilës ai vetë e kishte themeluar.	Presione të drejtpërdrejta ndërkombëtare që kulmuan me mbështetjen e Austro-Hungarisë ndaj Vidit si Princ të Shqipërisë, si dhe Traktati i Fshehtë të Londrës (prill 1915) ku Fuqitë e Antantës pranojnë krijimin e një shteti të vogël shqiptar në Shqipërinë e Mesme nën protektoratin italian. Territoret në Veri dhe Jug i jepen Serbisë dhe Greqisë.	Një tkurrje e hartës, me disa liderë lokalë që luftojnë për të krijuar principatat e tyre të vogla, ku ata mund të sundojnë nën mbrojtjen e ndonjërit prej shteteve fqinje të Ballkanit

Shqiptarët që jetojnë jashtë kufijve	Lojërat e konkurrencës së elitave	Kufizimet ndërkombëtare	Rezultatet e kufijve
(1912 -1914)	Elita bashkoi rreth e rrotull një projekt maksimalist <b>territorializimi</b> i cili kërkonte të krijonte një njësi të vetme politike. Gjendja e përgjithshme popullore ishte gjithashtu pro projektit të bashkimit duke i parë kështu rezultatet kufitare të Konferencës së Londrës vetëm si të përkohshme.	Presione të jashtme të larta duke kombinuar ato që vijnë nga Beogradi i cili miratoi shtypjen si një mënyrë për t'u marrë me nacionalistët shqiptarë, me aleatë si austriakët të cilët indirekt ndihmuan rezistencën në mesin e udhëheqjes së popullsisë shqiptare në Serbi.	Kështu, tkurrja e kufirit që shkoi kundër qëllimit maksimalist të 'Shqipërisë Etnike', ku kufijtë e kombit dhe të shtetit do të harmonizoheshin, për shkak të rezistencës së aktorëve ndërkombëtarë
(1914- 1917)	Mungesa e përplasjeve të elitës që rezultoi për shkak se shumë prej lidhësive të mëparshme ose kishte emigruar ose ishte internuar ose ishte jashtë mekanizmave të pushtetit.	Kufizime të jashtme të limituara në këtë periudhë, asgjë në veçanti nuk u vu në dukje në lidhje me ndërhyrjen ndërkombëtare.	Harta mbetet neutrale pa zgjerim ose rruhdhje/ ngushtim deri në Luftën e Parë Botërore, e cila ndryshoi situatën <i>de facto</i> në terren.

### **Kufijtë e imagjinuar kombëtarë: Ndryshimet në perceptimin e hartës nga masat në periudhën nga Shpallja e Pavarësisë në Luftën e Parë Botërore**

Disa ngjarje historike janë më të spikatura se të tjerat. Në këto momente kritike, mund të dallohen kthesa të dukshme. Nga Shpallja e Pavarësisë deri në Luftën e Parë Botërore janë dëshmuar konfigurime të caktuara të një harte mendore që ka ndikuar në imagjinimin e kufirit në të dyja anët e tij. Në shumë aspekte, elitat kosovare ishin zërat më aktive nacionaliste në mesin e popullit shqiptar, duke udhëhequr revolta dhe organizuar kaçakët kundër Perandorisë Osmane, sepse ata ishin relativisht autonomë nën Perandorinë Osmane, në krahasim me homologët e tyre në vilajetet poshtë në Jug. Kjo kishte pasoja afatgjata për shkak se ka shërbyer si një kujtim i vazhdueshëm i një "epoke të artë", kur shqiptarët ishin të gjithë të bashkuar, me Kosovën si rajoni më kryesor në luftën kundër armiqve të përbashkët dhe të ushqyer nga mite të ndryshme ekspansioniste.

Theksi në harmoninë e kufijve etnikë dhe kufijve politikë është një referencë e shpeshtë tematike që e gjejmë dominuese në diskursin publik, veçanërisht gjatë thyerjeve që lidhen me identitetin dhe shtetformimin.

Në kushtet e mungesës së përhapjes së asaj që studiuesi i njohur i nacionalizmit B. Anderson e quan efekti i ‘print kapitalizmit’ në formësimin e ‘komuniteteve imagjinare’<sup>36</sup> që bëjnë një komb të tillë, kjo bëhet e evidente në letërsinë gojore, mitologji, folklor etj., të cilat kultivojnë ndjesi të përbashkëta të përkituri, si parakusht i formësimit të identiteteve politike dhe formacioneve shtetërore.

Kjo vihet re në disa poezi të për zgjedhura më poshtë që reflektojnë sesi elita kulturore dhe politike arriti të ndërgjegjësojë masën e njerëzve drejt përfuturit të një identiteti kombëtar të lidhur ngushtësisht me territorin, pra një lloj territorializimi identitar, që do të shërbente në përfytyrimin e gjerë të masave. Për shembull në poezinë e Pashko Vasës "Oh Shqipëri, e mjera Shqipëri", e cila siç na informon dhe Elsie, “gradualisht brendashkruan në Gegërisht një ndjenjë të pan-nacionalizmit shqiptar”. Vargjet e fundit që mbyllin poezinë janë si më poshtë:

Qysh prej Tivarit deri n'Prevezë,  
Gjithkund lshon dielli vap'edhe rrezë,  
Asht tok' e jona, prind na e kanë lanë  
Kush mos na e preki, se desim t'tanë  
Të desim si burrat që vdiqnë motit  
Edhe mos marrohna përpara zotit.<sup>37</sup>

Duhet të theksohet se territoret e përmendura në njëfarë mënyre përvijonin Shqipërinë e imagjinuar, Shqipërinë e dëshiruar dhe kufijtë e Shqipërisë politike sipas konceptimit të elitës kulturore dhe politike të kohës. Kjo është ndoshta poema më shpesh e cituar në letërsinë shqiptare. Ajo u bë si një himn i Rilindjes në vend dhe u memorizua nga populli, kështu që ka qenë vendimtare në formësimin e kufijve mendorë kombëtarë në imagjinatën popullore në atë kohë. Ajo është ende një nga tekstet më të kërkuara për t'u memorizuar në klasat e letërsisë në shkollat fillore dhe të mesme shqiptare. Kjo poemë gjithashtu përmbante vargjet e përmendura më sipër, në lidhje me “feja e shqiptarit është shqiptaria” (një varg i gjendur zakonisht gjatë komunizmit), si një thirrje për të hequr qafe faktorin fetar që shihej si i ndashëm, për shkak të shumëqenësisë së komuniteteve shqipfolëse.

Një varg tjetër me ndikim është shkruar nga Hil Mosi, një poet, dhe më vonë ministër i Arsimit, i cili shkroi një poemë të quajtur "Kosova në

<sup>36</sup> Benedict Anderson, *Imagined Communities*. London: Verso, 2006.

<sup>37</sup> [http://www.teksteshqip.com/letersi/pashko-vasa/poezi\\_101206.php](http://www.teksteshqip.com/letersi/pashko-vasa/poezi_101206.php)

luftë", në vitin 1910, e cila është kompozuar më vonë edhe si një këngë me titull "Shqipëri, ky nuk është fundi yt". Ai e botoi atë në Stamboll, kur jetonte në atë kohë, por u këndua dhe ishte shumë e popullarizuar në Prishtinë në këtë periudhë kohore. Poezia më poshtë është një shembull:

### **Kosova në luftë**

Ah, Shypni, mos thuj mbarova,  
 Se djelmt tu edhe jan' gjall'!  
 N'kamb asht çu e rrebt Kosova  
 E ban luftën ball për ball. Ish një vjet' ndër ma të vshtira,  
 Me një mij nandqind e dhjetë,  
 Kur Kosov' mbloj egërsira,  
 Për me shbi çdo bim' mbi dhetë. Ish, por sa e nis njathera  
 Bota mbar' për m'u gjallsu  
 Kur me knaqje vjen prandvera  
 T'gjith natyren m'e lulzu. Ah, ehu! Do sheje t'kqia  
 Jan kah vin' prej ans mbi Le!  
 N'vent t'prendvers që pret Shqypnia,  
 Bje mbi të nj' e rrebt rrufe. Prej Azis' tek jan kah lshohen  
 Me tërbim të madh barbart,  
 Për me vra, me pre kta çohen,  
 Me turpnu për jet Shqyptart. E n'Prishtin' atje pik' s'parit  
 Krisi topi me duhi,  
 Atje gjaku i shqyptarit  
 Ra në tok' me bi përsri.<sup>38</sup>

Gjithashtu N. Mjeda, një politikan, ligjvënës dhe poet shkroi disa vargje interesante që përpiqeshin të fshihnin kufijtë 'e brendshëm' administrativë dhe 'të vështirë', duke conceptualizuar një hartë virtuale që do të shtrihej për të mbuluar territore më të shumta të pas rënies së Perandorisë Osmane. Poema e tij "Gjuha shqipe", si pjesë e ciklit të tij poetik "Liria" është cituar në gjatësinë e historisë së letërsisë shqipe, e shkruar rreth viteve 1910-1911, u bë një nxitës i fuqishëm për kryengritje të përgjithshme, që çoi në kërkesat e papritura për ndryshim nga autonomia drejt pavarësisë së plotë dhe unitetin e tokave shqiptarofolëse në një Shqipëri të vetme sovrane. Citojmë Mjedën më poshtë:

Geg' e tosk', malsi, jallia  
 jan' një komb, m'u da, s'duron;

<sup>38</sup> <http://www.poezishqip.com/hil-mosi/kosova-ne-lufte/>

fund e maj' nji a Shqipnia  
e nji gjuh' t'gjith' na bashkon.

Qoftë mallkue kush qet ngatrrime  
ndër kto vllazën shoq me shoq,  
kush e dan me flak' e shkrime  
çka natyra vet' përpoq.

Por me gjuhë kaq t'moçme e mjera  
si nj'bij' kjo që pa prind mbet:  
për t'huej t'mbajshin dhenat tjera,  
s't'kishte kush për motër t'vet.

E njat tok' që je tue gzue,  
e ke zan' tash sa mij' vjet,  
shqiptaria, që mbet mblue  
sot nën dhe, edhe shqip flet.<sup>39</sup>

Pra, mesazhi është i qartë, pavarësia dhe sovraniteti nuk janë të mjaftueshme në qoftë se komb-shteti i ri nuk përfshin të gjitha pjesët territoriale ku komunitetet shqip-folëse jetojnë dhe autori këtu mbikëqyr ndasitë fisnore, fetare dhe të tjera, duke bërë thirrje për unitet në të gjithë kufijtë 'materialë'.

Populli dëgjoi këto poezi dhe vargje të ngjashme, i lexoi me zë të lartë në kafenetë e qyteteve apo qendrat e fshatrave<sup>40</sup>. Ato prekën jo vetëm imagjinatën e tyre, ku shtriheshin kufijtë e jashtëm të kombit (duke fshirë dhe linjat ndarëse të brendshme), por edhe detyrën e tyre patriotike në mbrojtje të një atdheu në ndërtim e sipër. Kështu, duket se në njërin anë këta “agjitorë patriotikë” po bënin thirrje për heqjen e kufijve përçarës në mes të një etnie që kishte një gjuhë të përbashkët, por jo gjë tjetër dhe, në anën tjetër ishin sistematikisht duke ndërtuar kufij të rinj me 'të tjerët', në këtë kontekst, fqinjët sllavë.

Gjendja e përgjithshme popullore pas vitit 1913, në të dy anët e kufijve shtetërorë fillimisht ishte pro projekteve për bashkim, duke parë

<sup>39</sup> Koço Bihiku, *A History of Albanian Literature*. Tiranë: '8 Nëntori' Publishing House, 1980, pp. 50-51.

<sup>40</sup> Isa Blumi, “The Role of Education in the Formation of Albanian Identity and its Myths.” In Stephanie Schwander-Sievers and Bernd J. Fischer eds. *Albanian Identities: Myth and History*. Indiana: Indiana University Press, 2002.

kufirin e vendosur nga Konferenca e Londrës vetëm si të përkohshëm. Kjo është për shkak se kujtimet e fundit për një *Shqipëri Etnike* mbijetuan dhe shërbyen për të mbajtur gjallë shpresat për unifikimin e mundshëm dhe ndër masat e gjera popullore mbizotëronte mendimi ekspansionist, duke tejkaluar elitën politike në këtë proces e cila kishte ndarjet e saj që u vunë re edhe më lart. Kjo edhe për shkak se publiku në përgjithësi priret të jetë më tepër konservator në qëndrime se sa elitat të cilat marrin në konsideratë presione të brendshme dhe të jashtme në garën konkurrenciale për pushtet. Si rezultat, në këtë periudhë kemi (të paktën) një ligjërim për zgjerim kufitar që favorizonte konceptin e 'Shqipërisë së Madhe', ku kufijtë (maksimal) të kombit dhe të shtetit duhet të jenë të përputhshëm në mënyrë që siç shprehet një nga studiuesit e njohur të nacionalizmit,<sup>41</sup> shtet-kombi i ri të ishte një entitet funksional.

Ndërsa në Shqipëri ne shohim ambivalencën e elitave dhe ndryshime në imagjinatën kombëtare të vënë në dukje më lart, në Kosovë ne kemi një hartë më të qëndrueshme ekspansioniste gjatë kësaj periudhe. Udhëheqja kosovare dukej indiferente ndaj kufizimeve të jashtme, për shkak të represionit nga Beogradi dhe kishte pak për të humbur nga mbrojtja e qëllimeve irredentiste. Si rezultat i kësaj, vërejmë elitat që kufijtë e tyre të preferuar shndërrohen në kufij kombëtarë dominues në mendjet e shqiptarëve të zakonshëm duke përdorur poezinë, tekstet shkollore, himnet, etj., për disa vite të ardhshme apo dekada. Ndërsa, në Shqipëri harta shkoi vazhdimisht drejt fazave të ngushtimit / zgjerimit në përputhje me nivelin dhe shkallën e presioneve të jashtme dhe nivelin e betejave elitës në periudhën 1912-1917. Në Kosovë tekstet dhe diskursi dominues ishin ato që përshkruanin Shqipërinë e Madhe si një ideal politik që vazhdoi në formësimin e imagjinatës kombëtare në përputhje me rrethanat. Ndaj, elita e Kosovës, duke kërkuar në mënyrë koherente versionin ekspansionist të hartës të bazuar në idenë pjesore të Kosovës si epiqendër e kombit shqiptar, ka qenë më e suksesshme në gërshetimin e një harte maksimaliste të vazhdueshme në mesin e shqiptarëve që jetonin jashtë kufijve sesa në vetë Shqipëri.

---

<sup>41</sup> Gellner, Ernest, "The coming of Nationalism and Its Interpretation: The Myths of Nation and Class." In *Mapping the Nation*. Hopal Balakrishnan ed. London & New York: Verso, 1996.



Hartë 5: Territore shqiptare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni  
 Burimi: Perry-Castañeda Library, Map Collection, *Historical Maps of The Balkans*, "Historical Borders: Kosovo [1913-1992]" (218K)  
 Map from *Former Yugoslavia: A Map Folio*, U.S. Central Intelligence Agency 1992.  
 Posted at: <http://tinyurl.com/syjca>

Pra, nga 1912 deri më 1920, elita politike në Shqipëri ishte e lëkundur dhe pjesa më e madhe e energjisë ishte e drejtuar drejt ruajtjes së stabilitetit të brendshëm sesa maksimizimit të pretendimeve territoriale. Kjo u motivua gjithashtu edhe nga fakti se kufijtë zyrtarë të shtetit shqiptar u njohën vetëm më 1926<sup>42</sup> dhe mungesën e shtetit dhe institucioneve të tij për të vendosur autoritetin e nevojshëm.<sup>43</sup> Përrjashtimi

<sup>42</sup> Bernd Fisher, *King Zog and the Struggle for Stability in Albania*. Eastern European Monographs, 1986.

<sup>43</sup> Mazower e kap mirë këtë dinamikë kur vë re se "Shqipëria, kufijtë e së cilës u njohën vetëm në vitet 20-të, kërkonte rivendikimin e territoreve të saj në Greqi dhe Jugosllavi në këtë periudhë." Mark Mazower, *The Balkans: A Short History* (Weidenfeld and Nicolson, 2000), reprinted as *The Balkans: From the End of Byzantium to the Present Day* (Phoenix, 2002), f. 125-126.

i vetëm ishin ata shqiptarë të Kosovës që luajtën një rol direkt dhe të qenësishëm në vendin amë dhe që avokatuan pa u lodhur një agjendë politike, që do të kishte si qëllim kryesor rivendikimin e territorit të cilin e konsideronin të humbur padrejtësisht si rezultat i intrasigjencës së Fuqive të Mëdha.

Por, duhet thënë që pavarësisht retorikës nacionaliste të motivuara nga konkurrenca e elitave dhe përplasjet e projekteve të tyre si dhe burimet e jashtme që financonin, perceptimi publik në Shqipëri nuk ishte mjaft mikpritës. Kjo sepse pjesa më e madhe e njerëzve ishin thjeshtë të pandikuar për shkak se popullata ishte kryesisht analfabete, rurale dhe që jetonte në komunitete të izoluar me pak infrastrukturë që do bënte të mundur të jetuarit bashkë apo të imagjinuarit si një komunitet i vetëm.<sup>44</sup>

Në kujtimet e tij, të ripublikuara pak kohë më parë, kleriku rilindas Ibrahim Dalliu shkruan se në Tiranën e fillim shek.XX, pjesa më e madhe e njerëzve ishin në fakt indiferent ndaj krijimit të një republike të mëvetshme të Shqipërisë, duke quajtur realisht *shqiptarë* vetëm aktivistët e lëvizjes kombëtare.<sup>45</sup> Kjo lloj evidence na shërben për të kuptuar të menduarit e intelektualëve të kohës dhe se si këta të fundit e shihnin rolin e tyre parësisht si edukues të masave dhe së dyti si *agjikatorë patriotikë*<sup>46</sup> që po mobilizonin popullatën drejt një vetëdije të re identitare që do të materializohej në komb-formim.

Një e dhënë interesante na vjen gjithashtu nga teksti i historisë së Konstandin Çekrezit *Historia e Shqipërisë* që në 1921, i cili kur diskuton pasojat e Kongresit të Berlinit, shkruan në mënyrë literale: “Kongresi vendosi që të zmadhonte tokat e Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë, duke ia marrë ato Shqipërisë. Mal i Zi do të merrte Gusinje, Plavën dhe Trepshe; Serbia do të merrte Krumsheline dhe Vranje; Greqisë do t’i njohej pjesa më e madhe e rajonit të Toskërisë”<sup>47</sup>. Periudha kur u shkrua ky tekst i parë i mirëfilltë historie nga një anëtar i njohur i diasporës shqiptare përkonte me shtet-formimin e fillimviteve 20-të, menjëherë pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, ku nevoja për të rikonceptuar

<sup>44</sup> Benedict Anderson, *Imagined Communities*. London: Verso: 1991 (2006).

<sup>45</sup> Ibrahim Dalliu, *Patriotizma në Tiranë*, Tiranë: Dudaj: 2000.

<sup>46</sup> Hroch, Miroslav, “From National Movement to the Fully-formed Nation: The Nation-building Process in Europe.” Në *Mapping the Nation*. Hopal Balakrishnan ed. London & New York: Verso: 1996.

<sup>47</sup> Konstandin Çekrezi, *Historia e Shqipërisë*. Boston: Dielli Printing Press. 1921, p. 190.

Shqipërinë ‘natyrale’ dhe copëtimin e saj para se Republika e Shqipërisë të shpallej si e tillë, kërkonte si parakusht një narrativë të sistematizuar që revokonte padrejtësitë e Fuqive të Mëdha dhe linte të nënkuptohej nevojën për revizionim të kufijve në një të ardhme të afërt. Kjo narrativë na shërben për të kuptuar vizualizimin e territorit, kufijve dhe hartës kombëtare dhe të shtetit në mendjen e nxënësve dhe masës së popullit në përgjithësi, çka vlen për të kuptuar dinamikën e shpërhapjes së ligjërit të elitës kulturore në masë. Për ta bërë të shtrirë në kohë dhe hapësirë këtë narrativë, klishe të tilla gjenden rëndom në tekste të tilla si ky i Çekrezit, për shembull si: “nën mbretërinë e Skënderbeut, Shqipëria u njoh si një nga vendet më të fuqishme në Evropë”<sup>48</sup> ose “sikundër mund të vihet re, në këtë kohë Shqipëria ishte e lirë por e ndarë më dysh: një pjesë nën Mustafa Pashën, tjetra nën Ali Pashën”<sup>49</sup>, duke krijuar përshtypjen e një bashkësie territoriale dhe etnike të pandarë dhe të njëtrajtshme në rrafshin diakronik.

Pra, kur kufijtë e brendshëm nisën të stabilizoheshin me fundin e Luftës së Parë Botërore, fillojmë të kemi një konsensus gradual drejt një harte etnike konsensuale, fillimisht mes elitës kulturore por duke qenë se pjesa më e madhe e tyre ishin dhe aktivë në politikë (Fishta, Mjeda, Noli etj.), edhe elita politike shpejt përqafoi këtë hartë me pretendime territoriale që përfshinin Shqipërinë ‘natyrale’. Kufijtë virtualë ndodheshin në një situatë fluide ku luhateshin mes një pozicioni institucionalist, që shihte kufijtë e shtetit aktual dhe kombit si unitarë dhe një pozicioni maksimalist që kufijtë e shtetit i shtrinte deri në përfshirjen e krejt kufijve ‘imagjinarë’ të kombit dhe që mund të realizohej vetëm kur kushtet gjeopolitike të piqueshin plotësisht dhe përkrahja ndërkombëtare të mundësohej. Një nga shembujt që ilustron këtë të fundit është edhe poema “Shqypnia e Lirë” e At. Gjergj Fishtës:

### **Shqypnia e Lirë**

Po, por nesër, me ndimë të Zotit,  
Do t’a bajm prap Shqypni t’lir  
Prej Prevezet e m’Leqe t’Hotit,  
Prej Tivarit e m’Monastir;  
Edhe Flamuri i Shqypnis,  
Si flakë mnijet t’Perendis,

<sup>48</sup> *Po aty*, f. 105-106

<sup>49</sup> *Po aty*, f. 159-160

Do t'valvitet në Kaçanik.  
 M'Kaçanik, po, do t'valvitet  
 Kuq e Zi, Flamri i Shqypetarëve,  
 Përse toka, shqyp ku flitet,  
 Ajo vetë asht që prej të Parvet  
 Trashigimin na e kemi pasë:  
 Mbrendë i huej ma s'do të shklasë,  
 Jo, po: na sod ktu sundojm;  
 Ktu s'hecë fjala e tjetër kuej;  
 Gjall lirinë na nuk e lshojm,  
 S'njohim mbret as krajl të huej,  
 Zoti n'qiell e na mbi tokë  
 Me gjithkendë vëllazën e shokë,  
 Por secili në cak të vet.  
 Prandej i hueji në andërr m'e pa  
 Se vjen kurr e shklet nder ne,  
 Drue se keq kishte me i ra.<sup>50</sup>

Këtu shohim një hartë ekspansioniste që riaktivizon ëndrrat e vjetra të agjitorëve nacionalistë për të krijuar një Shqipëri Etnike. Fishta është i kujdesshëm për të na dhënë një hartë të saktë të ambicies territoriale të asaj që ai e konsideron që në titull si “Shqipëria e Lirë”<sup>51</sup> që shkon prej Preveze në Greqinë e Veriut në Hot dhe Tivar të Malit të Zi dhe Manastir (Bitola) në Maqedoni. Simbolikisht flamuri kuqez i do të ngrihej në Kaçanik të Kosovës si epiqendra e komb-shtetit imagjinar.

### Përfundime

Pjesa e parë e punimit, fillimisht përvijoi mënyrën se si përplasia e projekteve të elitave ishte determinuese në formësimin dhe lidhjen e identitetit politik me një territor të caktuar, me kufij të imagjinuar dhe të mbrujtur me vlera simbolike, e cila nga ana tjetër është një parakusht thelbësor se si harta kombëtare perceptohet nga njerëzit. Më pas, studimi u fokusua te ndryshimi i konceptimit dhe instrumentalizimit të kufijve në nivele të elitës, të shkaktuara nga përplasjet e përsëritura dhe të kushtëzuara nga politika e Fuqive të Mëdha, si dhe perceptimi i publikut i

<sup>50</sup> Fishta, Gjergj. 1921. *Shqypnia e Lirë*. Poem.

<sup>51</sup> Duke nënkuptuar në mënyrë indirekte që Shqipëria pa këto territore të ‘humbura’ nuk do të ishte asnjëherë plotësisht e lirë dhe sovrane.

hartave virtuale dhe analizuam se si, kur dhe pse kemi pasur shkëputje në disa faza kritike.

### *Summary*

#### THE TERRITORIAL CHANGES AND THE DRAWING OF THE BORDERS: THE CASE OF ALBANIA; THE CLASH OF ELITES, THE INTERNATIONAL INTERVENTION AND THE COLLECTIVE IMAGINATION (1912-1920)

This paper shows that the main drivers of mental shifts in the interwar period were the *competing elites*, who through various projects that suit their political calculations dictate the expansionary/contractionary maps of the Albanian nation, always in conjunction with the other determining factor, the external constraints and foreign pressures. As it is shown here, the first political demands for full sovereignty started around the end of 1911, beginning of 1912 and the best causal explanation based on empirical analysis, leads to the argument of competing elites in order to secure political power, when geopolitical pressures allowed for it. The 'external' elites, which included 'overseas' diasporas who were mostly individuals that were serving Ottoman Empire in high levels of power (including such positions as foreign minister, governors or deputies of the Parliament), saw the existing structures of power suddenly collapsing and tried to embark into a new venture project, which was the leading of the process of nation-building that culminated with the new Albanian state. These efforts paid off since they succeeded in securing their former positions, albeit in a different context. Thus it seems that achieving political power through mapping of nation and borders that would facilitate such goal, has been the main drive of rhetoric and actions of the elite in maximizing the maneuvering room allowed by international actors as it is argued here.